VENDIM
Nr.1578, datë 3.12.2008

PËR MIRATIMIN E VLERËS SË TË DREJTAVE, QË LIDHEN ME AKSIONET E SHTETIT NË INSIG, SHA, ME TË CILËN DO TË FILLOJNË NEGOCIATAT PËR SHITJEN E TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.9649, datë 27.11.2006 "Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të INSIG, sh.a.-së", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e vlerës së aksioneve të shtetit në INSIG, sh.a., sipas raportit të hartuar nga vlerësuesi ndërkombëtar KPMG.

2.Vlera mesatare, e përcaktuar nga vlerësuesi ndërkombëtar, me të cilën do të fillojnë negociatat për shitjen e të drejtave të shtetit në aksionet e INSIG, sh.a.-së të jetë vlera më e ulët.

3.Nëse blerësit e mundshëm ofrojnë çmime blerjeje nën vlerën mesatare, sipas pikës 2 të këtij vendimi, të negociohet me ofertuesit, për rritjen e çmimit të ofruar. Kriteri i vetëm për përzgjedhjen e blerësit do të jetë çmimi më i lartë i ofruar, i cili nuk mund të jetë më i ulët se vlera mesatare, e përcaktuar në raportin e vlerësuesit ndërkombëtar.

4.Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha